

REPUBLICA E KOSOVËS  
Republic of Kosovo  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
Kosova Academy of  
Sciences and Arts

Nr.: 1086  
Fq: 1  
Dt: 23.12.2022  
PRISHTINË

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

KUMTESE

Lidhur me debatin që ka shpërthyer në publik rreth botimit dhe shpërndarjes së paautorizuar të Dokumentit “SYNIMET DESTABILIZUESE TË SERBISË NË KOSOVË DHE NË BALLKANIN PERËNDIMOR,” Seksioni i Shkencave Shoqërore, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2022 jep këto sqarime:

1. Seksioni i Shkencave Shoqërore distancohet nga Dokumenti i publikuar në faqen zyrtare elektronike të AShAK dhe sqaron se ai është tekst i Kryetarit të Akademisë, z. Mehmet Kraja, i paautorizuar për publikim. Seksioni, që në fillim e ka kundërshtuar publikimin e këtij teksti joshkencor në emër të Akademisë, që shihet nga Procesverbali i mbledhjes së 26 janarit 2022!
2. Seksioni i Shkencave Shoqërore ka kohë që ia ka tërhequr vërejtjen Kryetarit të ASHAK-ut z. Mehmet Kraja për sjelljet imponuese e arbitrare, e që po e lëndojnë rëndë dinjitetin e institucionit në krye të të cilit është. Me qasjen e tij jo-akademike dhe veçanërisht me publikimin e këtij dokumenti joshkencor, të hartuar nga vet ai, si drejtues i një institucioni prestigjioz shkencor, artistik dhe kulturor, sjellë përçarje me pasoja të rënda për vet Akademinë.
3. Për shkak të papërgjegjësisë dhe veprimeve imponuese dhe arbitrare, Seksioni i Shkencave Shoqërore kërkon nga z. Kraja reflektim institucional dhe moral për dëmin e shkaktuar ndaj Akademisë dhe publikut të gjerë.
4. Nëse z. Kraja nuk reflekton karshi përgjegjësisë institucionale dhe morale, Seksioni i Shkencave Shoqërore do të iniciojë veprime të tjera statutoare.

23 dhjetor 2022

Për Seksionin e Shkencave Shoqërore

Gjyljeta Mushkolaj, Anëtare Korresp.

